

BM
MGL

STATUTI DHE AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR "RED SKY IT" SH.P.K.

Sot, më 26/12/2022 ne ortakët:

1. Bruno Miguel Perpetua Ventura shtetas portugez, i biri i Armando Ferreira Ventura i datelindjes 02.04.1977 banues ne Portugali me adresë: Quinta da Várzea, Rua Padre João, Pontéve, mbajtese e leternjoftimit me Nr CC318815 madhor dhe zotesi juridike te plete per te vepruar.
2. Magda Sofia Cabeças Lapa, shtetase portugeze, e bija e Fernando Jose Pires Lapa e datelindjes 22.02.1978, banuese ne Portugali me adresë Quinta da Várzea, Rua Padre João, Pontével, mbajtese e leternjoftimit me Nr CB414573 madhore me zotesi juridike te plete per te vepruar.

Te cilet me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë në cilësinë e ortakeve të shoqërisë në krijim e sipër bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi hartojnë akt themelin dhe këtë statut të shoqerisë tregtare RED SKY IT e cila ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (shpk), e cila do te funksionoje në përputhje me ligjin shqiptar dhe në përputhje me këtëstatut.

BAZA LIGJORE

- “Kushtetuta e Republikës se Shqiperise”;
- “Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;
- “Ligji Nr. 9723, dt. 03/05/2007 “Për Qëndren Kombëtare te Rregjistrimit”;
- “Kodi Civil i Republikës se Shqipërise”;

STATUTI

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 1

Emërtimi i Shoqerisë

Kemi vendosur krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar me emrin "RED SKY IT" SH.P.K. me poshtë e quajtur edhe Shoqëria. Emri i shoqërisë mund të ndryshohet vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme.

NENI 2

Forma e Shoqërisë

Shoqëria tregtare "RED SKY IT" shpk është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

Bruno Miguel
NENI 3

Selia e Shoqerise

3.1 Selia e shoqërisë "RED SKY IT" SH.P.K. është: Durres, Rruga Plazhit /13 Hyrja 1 Apartamenti 1, Zone Kadastrale 8518, Nr Pasurie 60/100/ND +1-1
Ndryshimi i selisë së shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme

NENI 4

Objekti i aktiviteti:

Objekti i veprimtarise ne kesaj shoqerie eshte:

Prodhimi dhe zhvillimi i software-ve.

NENI 5

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë "RED SKY IT" SH.P.K. do të jetë për një periudhë të pacaktuuar duke filluar nga moment i rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Tirane

NENI 6

Filiale dhe zyrat e perfaqësisë

Shoqëria Tegtare "RED SKY IT" SH.P.K. mund të ketë filial ose zyra përfaqësie në territorin Shqiptar ose të huaj nëse do të vendosë asamblea e ortakëve.

KREU III

NENI 7

Kapitali themeltar I shoqërisë

7.1 Kapitali themeltar fillestar I shoqërisë është 10.000.000(dhjete million)lekë.

7.2 Kapitali themeltar I Shoqërisë përbëhet nga 2 kuota e gjitha e nënshkruar dhe firmosur

NENI 8

Kontributet

8.1 Bruno Miguel Perpetua Ventura 1 (një) kuote me vlerë te përgjithshme 5.000.000 (pesemilion) lek e cila korrespondon me 50% te kapitalit te shoqerise.

8.2 Magda Sofia Cabeças Lapa 1 (një) kuote me vlerë te përgjithshme 5.000.000 (pesemilion) lek e cila korrespondon me 50% te kapitalit te shoqerise

8.3 Kapitali themeltar i përbërë nga 2 kuota është shlyer dhe nënshkruar i gjithi sipas përqindjes të ortakeve

Myl
Bra

NENI 9

Zmadhimi i kapitalit

- 9.1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet pa limit një ose më shumë herë me anë të vendimit të asamblesë së ortakëve;
- 9.2. Në rast të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë, ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë dhe paguajnë pjesën e kapitalit të zmadhuar në proporcion me pjesën takuese të pjesëmarrjes në kapitalin social të shoqërisë.

NENI 10

Zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë

- 10.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin e saj me vendim të asamblesë së ortakëve. Në cdo rast, kapitali i regjistruar i shoqërisë nuk mund të ulet nën limitin dysheme të vodosur me ligj;
- 10.2 Zvogëlimi i kapitalit social i prek ortakët në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e shoqërisë, përvec rastit kur asamblea e përgjithshme mund të vodosë ndryshe.

NENI 11

Transferimi i kapitalit

11.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të kalohen të tjerëve plotësisht ose pjesërisht;

11.2 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të kalohen të tjerëve plotësisht ose pjesërisht personave të tretë jashtë kësaj shoqërie, por duke respektuar këto klauzola:

- Ortakët kanë të drejtën e parablerjes për kuotat që dëshiron të trasferojë/kalojnë
- Ortakët nuk kanë të drejten e shitjes së kuotave të tij tek të tretë pa marrë më parë miratimin me shkrim nga pala tjetër e ortakërisë
- Ortakët kanë të drejtën e parablerjes së kuotave me të njëjtat kushte dhe të njëjtin çmim me të cilin ortaku mund të ja shiste një personi të tretë kuotën e tij. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga momenti i komunikimit për shitjen ortakët duhet të ushtrojnë të drejtën e tyre të parablerjes, në rast të kundërt do të konsiderohet se kanë hequr dorë nga kuota;
- Në rast se ortaku që dëshiron të shesë kuotën e tij, ja kalon një personi të jashtën nga shoqëria me kushte më të favorshme në krahasim me ato të ofruara ortakëve në lidhje me të drejtën e parablerjes nga ana e tyre, atëherë kontrata për kalimin e kuotave që do të nënshkruar me personin e tretë nuk do të jetëi vlefshëm dhe shoqëria dhe ortakët nuk do të jepin miratimin për këtë kalim duke u bërë shkak në këtë mënyrë për pavlefshmëri të kontratës së shitjes së kuotave të kapitalit.

11.3 Të gjitha komunikimet midis ortakëve do tëbëhem me shkrim dhe me postë rekomande me lajmërimim marrje,

MGJ
BM

KREU IV

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 12

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

NENI 13

Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisënë lidhje me çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) largimin dhe perjashtimin e ortakeve;
- j) Marrjen kredi apo hipotekimin e aseteve te shoqërisë.
- k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

NENI 14

Mbledhja e asamblesë së përgjithshme

14.1 Asambleja e përgjithshme thirret në rastet e parashikuar nga ligji ose në statut, sa herë do të konsiderohet e nevojshëm për mbrojtjen e interesave të shoqërisë

14.2 Asamblea duhet të thërritet të paktën një herë në vit;

14.3. Asamblea e përgjithshme thirret sipas parashikimeve të nenit 83 dhe 84 të ligjit nr. 9901, datë 14.01.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";

14.4. Ortakët do të njoftohen nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike.

14.5. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas këtyre rregullave dhe sipas këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë;

14.6. Mbledhja e përgjithshme e asamblesë mund të mbahet në selinë qendrore të shoqërisë ose në një vend tjeter të përcaktuar.

NENI 15

Pjesëmarrja në vendime

15.1 Ortakët kanë të drejtën e votës në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin social;

15.2. Ortakët mund të përfaqësohen në asamble nga një person i tretë në bazë të një autorizimi. Ky autorizim mund të lëshohet për një mbledhje të vetme ose mbi më shumë mbledhje.

NENI 16

Procesverbal i mbledhjes

16.1 Të gjitha vendimet e mbledhjes do të regjistrohen në procesverbal. Prosesverbal duhet të përcaktojë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e presidentit të mbledhjes, emrin e sekretarit të mbledhjes dhe rezultatin e votimit;

16. 2 Presidenti i mbledhjes përcakton kush do të jetë sekretari për redaktimin e procesverbalit i cili mund të mos jetë ortak. Prosesverbal duhet të nënshkruhet nga presidenti dhe nga sekretari.

16. 3 Prosesverbalit i bashkëlidhet emrat e personave prezent dhe njoftimi për thërritjen e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.

NENI 17

Administratori

17.1 Administratori është organi ekzekutiv i shoqërisë

17.2 Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Administratori ka të drejtën e administrimit të zakonshëm të shoqërisë.

*Hyc
BW*

17.3 Ka të drejtë kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

17.4 Ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë tregtare përpara cdo institucioni publik ose privat;

17.5 Ka të drejtë të përgatisë cdo lloj akti të nevojshëm për ecurinë e shoqërisë dheta depozitojë pranë cdo institucioni publik ose privat sipas ligjeve në fuqi;

17.6 Merret me menaxhimin e përditshëm të shoqërisë duke kryer të gjitha aktivitete e nevojshme për menaxhimin dhe mbikqyrjen e personellit; kryen punësimet dhe pushimet nga puna; përcakton udhëzime për kryerjen e detyrave për aktivitetin e shoqërisë; mban korrespondencën e shoqërisë; autorizon mblerjen, qiran e sendeve ose shërbimeve të nevojshme të lidhura direkt ose indirect me aktivitetin tregtar të shoqërisë; autorizon kryerjen e trasfertave bankare ose tërheqjen e shumave nga llogaritë rrjedhëse të shoqërisë në lidhje me pagesat e pagave ose shpërblimet e punonjësve të shoqërisë; firmos faturat për shërbimet

dhe veprimet që shoqëria kryen; kryen të gjitha veprimet e nevojshme përsa i përket nënshkrimit të cdo pagese bankare, depozitat, tërheqjet, derdhjet ose trasfertat të ndryshme në llogaritë e shoqërisë të të gjitha llogaritë e shoqërisë, pranë cdo banke në të cilën llogaritë janë hapur;

17.7 Përfaqëson shoqërinë në lidhje me cdo kontratë ose marrëveshje me të tretët persona fizike ose juridike, vendas ose të huaj, me intitucionë ose ente publike të cfarë do lloji;

17.8 Për admnistrimin e jashtëzakonshëm të shoqërisë që kalon tagrat e mësipërm administratori duhet paraprakisht të ketë marrë miratimin e asamblesë së përgjithshme.

17.9 Admnistrator i shoqërisë RED SKY IT shpk do të jetë Z.Bruno Miguel Perpetua Ventura shtetase portugez , I biri i Armando Ferreira Ventura e datelindjes 02.04.1977 banues ne Portugali me adresë Quinta da Várzea, Rua Padre João,Pontéve mbajtes i leternjoftimit me Nr CC318815 madhor dhe zotesi juridike te plete per te vepruar i cili do të admnistratojë aktivitetin e zakonshëm të shoqërisë, ndërsa përsa i përket admnistrimit të jashtëzakonshëm, hapjen e llogarive bankare, depozitat, marrja krediti ose hipotekim te pasurive të shoqërisëdo të jetë e nevojshme gjithmonë vendim i asamblesë së ortakëve me një afat kohor 5 vjet duke filluar nga dt 26/12/2022-25/12/2027 me te drejte rinovimi.

KREU V

Ekspertet kontabel, viti Financiar dhe Bilanci, Destinimi i të ardhurave

Neni 18

Viti Financiar dhe të ardhurat

18.1 Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mylllet me 31 Dhjetortë po atij viti.

18.2 Bilanci vjetor, inventari, raporti mbi ecurinë e aktivitetit tregtar dhe rapporti i ekspertit kontabël të autorizuar aprovohen nga asamblea e përgjithshme.

18.3 Bilanci dhe pasqyrat financiare për vitin financiar duhet të aprovohen brenda 3 muajve nga përfundimi i vitit financiar

Bru
MQL

NENI 19

Shpërndarja e të ardhurave

Të ardhurat i shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesëmarrjen dhe kuotat e tyre

Shoqëria mund të shpërndajë të ardhurat vetëm nëse:

- Aktivet e shoqërisë mbulojnë plotësisht detyrimet e tyre;
- Shoqëria posedon aktive në likuiditet të mjaftueshme për të mbuluar detyrimet qe bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve të ardhshëm.

KREU VI

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

NENI 20

Mbyllja dhe likuidimi

20.1 Shoqëria shpërndahet ose prishet në cdo kohë në rastet e parashikuar nga ligji ose asamblea e përgjithshme :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

20. 2 Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “ Shoqëri në likuidim e sipër ”.

20.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

20.4 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

20. 5 Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

KREU VII

DISPOZITA TË FUNDIT

NENI 21

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqerise dhe të tretëve, do të zgjidhen me marrëveshje në rast se nuk arrihet marrëveshja atëherë kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 22

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë

Ky statut është mbajtur në 4 kopje në gjuhë shqiptar

Ortaket e shoqerise

Bruno Njeguši Perpejku Vendax

Magdalena Kukeli